



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri
Mbledhja nr. 52
Prishtinë, më 27 shtator 2010
Ndërtesa e Kuvendit, sala N-225
Mbledhja filloi në orën 11:00

P R O C E S V E R B A L

I mbledhjes së Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri

Morën pjesë: Rustem Mustafa, Shkumbin Demaliaj, Eqrem Kryeziu, Basri Musmurati, Ismet Beqiri, Lulzim Zeneli dhe Radmila Vujoviq - anëtarë të komisionit.

Munguan: Suzana Novoberdaliu dhe Zylfi Merxha - anëtarë të komisionit.

Nga Zyra Mbështetëse morën pjesë: Antigona Ibraj, dhe Nuredin Ibishi.

Mbledhjen e kryesoi: Rustem Mustafa, kryetar i komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur me datë **08.09.2010**
3. Shqyrtimi i projektligjit për pajisje me armë, municion dhe pajisje përkatëse të sigurisë për institucionet e autorizuar shtetërore për siguri
4. Shqyrtimi i projektligjit për shërbimet e sigurisë private
5. Të ndryshme

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të 08.09.2010

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur me datë 08.09.2010 u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i projektligjit për pajisje me armë, municion dhe pajisje përkatëse të sigurisë për institucionet e autorizuarra shtetërore për siguri

Kryetari i Komisionit – Projektligji për pajisje me armë, municion dhe pajisje përkatëse të sigurisë për institucionet e autorizuarra shtetërore për siguri është miratuar në lexim të parë në Kuvend me 23 shtator 2010. Ne si komision funksional duhet ta shqyrtojmë këtë projektligj, pra ne sot duhet ta caktojmë referuesin, unë propozoj z.Basri Musmurati, nëse është i gatshëm të jetë referues për këtë projektligj.

Basri Musmurati- Po unë kamë punuar edhe në Projektligjin për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit Nr.03/L-037 për Dokumentet e Udhëtimit, andaj mund të punoj edhe në këtë projektligj.

Shkumbin Demaliaj- Unë kam qenë referues i projektligjit për Armë dhe jam i gatshëm me shtri aktivitetin tim edhe për këtë projektligj sepse kemi pas një punëtori të madhe bashkë me stafin dhe UNDP. Unë jam referues edhe i projektligjit për Inspektoratin Policor por për atë i kemi bërë përgatitjet dhe besoi që do të përfundohet shpejt andaj jam i gatshëm ti ndihmoj z.Basri Musmurati ne këtë projektligj.

Kryetari i Komisionit- Me pajtimin e anëtarëve të komisionit, konstatoi që për këtë projektligj u caktua referues z.Basri Musmurati.

4. Shqyrtimi i projektligjit për shërbimet e sigurisë private

Kryetari i Komisionit- Ky projektligj është kthyer më herët nga komisioni i ynë te sponsorizuesi, tani ka ardhur prapë. Komisioni ynë është komision funksional për këtë projektligj. Unë kam biseduar me z.Lulzim Zeneli që të jetë referues për këtë projektligj dhe ai është pajtuar, a jeni të pajtimit që referues të jetë z.Lulzim Zeneli.

Komisioni konstatoi që referues për Projektligjin për Shërbimet e Sigurimeve Private, të jetë z.Lulzim Zeneli.

Kryetari i Komisionit – Kërkoj nga anëtarët e komisionit që të punohet sa me intensivisht në shqyrtimin e këtyre projektligjeve në mënyrë që projektligjet të kryhen në kohen e paraparë.

5. Të ndryshme

Kryetari i Komisionit – A ka dikush diçka në lidhje me këtë pikë.

Shkumbin Demaliaj- Unë kisha propozuar që ta ftojme në një takim Ministrin e Punëve të Brendshme, që të njoftohemi rreth të arriturave që janë bërë me rastin e ndërrimit të ministrave, pra te jemi të njoftuar si komision rreth ndryshimeve që janë bërë.

Kryetari i Komisionit – Kërkojmë nga stafi që ta planifikojnë që në një mbledhje të radhës të ftohet Ministri në takim para komisionit. Unë dua ta paraqes një shqetësim rreth kidnapimeve të personave dhe në një takim të radhës ne duhet ta kem një debat në lidhje me këtë çështje, sepse këto janë dukuri që nuk duhet të ndodhin.

Pasi nuk kishte pika të tjera për diskutim, kryetari i Komisionit e mbylli takimin.

Mbledhja përfundoi në orën 11:35.

E hartoi:

Njësia Mbështetëse e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Rrustem Mustafa